

V E N D I M
Nr. 703, datë 27.12.2001

**PËR SKEMËN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMIT TË
BUKËS DHE TË DISA ARTIKUJVE USHQIMORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Skema e kompensimeve, që rrjedh nga liberalizimi i çmimit të bukës e të disa artikujve ushqimorë që përfitohen nga pensionistët, për anëtarët e familjes, në ngarkim të tyre, mbështetur në vendimet nr. 310, datë 24.7.1992, dhe nr. 274, datë 12.6.1993 të Këshillit të Ministrave do të jetë:

- a) Në kuptim të këtij vendimi, quhen persona në ngarkim të pensionistëve:
 - fëmijët nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën;
 - nipat dhe mbesat, kur nuk i kanë prindërit, të cilët bashkëjetojnë me pensionistin dhe janë nën moshën 18 vjeç ose deri në 25 vjeç, kur vazhdojnë shkollën;
 - bashkëshorti, prindërit, njerku e njerka që nuk kanë të ardhura.

b) Përfitojnë kompensime në masën 414 lekë në muaj për çdo person në ngarkim, personat që përfitojnë ose do të përfitojnë sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë", me banim të përhershëm në qytet dhe qendra të banuara, të njohura nga organet e pushtetit vendor.

c) Përfitojnë kompensime në masën 414 lekë në muaj, për çdo person në ngarkim, personat që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" dhe ata që përfitojnë ose do të përfitojnë pension sipas paragrafit të dytë, të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" me banim të përhershëm në qytet.

ç) Nuk përfitojnë kompensime sipas këtij vendimi, pensionistët që realizojnë të ardhura nga veprimtari ekonomike, (të punësuar, punëdhënë, të vetëpunësuar, ose kur kanë tokë në pronësi, përdorim, pavarësisht nga vendbanimi.

d) Kur më shumë se një person në familje merr pension nga sigurimet shoqërore apo të ardhura nga veprimtari ekonomike, masa e kompensimit që përfitohet sipas pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi përpjestohet ndërmjet tyre.

dh) Kompensimet për efekt të zbatimit të këtij vendimi llogariten dhe administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore pas paraqitjes nga pensionisti të deklaratës personale, të shoqëruar me certifikatën e gjendjes familjare, me vërtetimin nga zyrat e tatim-taksave, se zhvillon ose jo veprimtari ekonomike dhe vërtetimin nga zyrat e regjistrimit të pasurisë për pronësinë mbi tokën.

2. Shkronja "a" e pikës 2 të vendimit nr. 310, datë 24.7.1992 të Këshillit të Ministrave dhe pika 1/7 e vendimit nr. 274, datë 12.6.1993 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

3. Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi të përlllogariten çdo vit në buxhetin e sigurimeve shoqërore dhe të përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2002.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta